



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 10.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 117/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.03.2021, të parashtruar nga Grupi i OE "MARISA SHPK DHE COMPANY MURSELI" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkingjeve dhe stacioneve të autobusëve", me Nr. të Prok: 632-20-7006-5-1-1, nxjerr:

### VENDIM

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik "MARISA SHPK DHE COMPANY MURSELI" e datës 05.03.2021, lidhur me aktivitetin e "Ndërtimi i parkingjeve dhe stacioneve të autobusëve", me Nr. të Prok: 632-20-7006-5-1-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK -së, të datës 01.03.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 01.03.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Arsyetim

Grupi i Operatorëve Ekonomik **MARISA SHPK DHE COMPANY MURSELI** me datë 05.03.2021, ka parashtruar Kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Ndërtimi i parkingjeve dhe stacioneve të autobusëve"**, me Nr. të Prok: **632-20-7006-5-1-1**.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 10.03.2021, ka shqyrtuar Kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Në lidhje me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkoj sqarime shtesë për ISO standarde nuk qëndron sepse sipas LPP-së dhe RRUOPP-ë, sqarimet MUND të kërkojnë- pra nuk janë të detytrueshme dhe meqenëse ju keni qenë i përgjegjshëm nuk ju janë kërkuar sqarime shtesë;

2. Për sa i përket pretendimit tuaj të dytë, Autoriteti kontraktues sqaron se nuk janë dorëzuar referenca të ngjashme për kryerje të punëve-furnizim dhe vendosje të kabinave. Në vendimin e OSHP-së, ka qenë pikë ankimore për fituesin "Selmans Network" jo për "MARISA "SHPK DHE COMPANY MURSELI";

3. Për pretendimin tuaj se:

*"Gjithashtu ju nuk mund të kërkon referenca furnizimi pasi që dosja e tenderit është Kontrat "PUNE" nuk është "Furnizim" pasi që aty nuk ka me pjesë furnizuse po ndertim te stacioneve te autobuseve,*

*Furnizim mund të kërkojë vetëm në rastë kur Materiali do duhet të dorzohet në stoqe të AK, pra në këtë projekt behet fjale për ndertim jo furnizim",*

Autoriteti kontraktues sqaron se ky pretendim nuk qëndron sepse ka edhe kontrata të përziera siç është edhe ky projekt dhe për këtë pikë keni mundur të kërkonit sqarime PARA HAPJES, apo të bëni kërkesë për rishqyrtim;

4. Për pretendimin tuaj se:

*"Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakoves përkatësisht zyrja e prokurimit dhe komisioni vlersues ka tentuar të bëjë diskriminim ndaj kompanive dhe keq menaxhim të paras publike, ku e ka shpallur fitues nje kompani pa i plotësuar kushtet dhe kriteret për kontrat por me çmimin më të lartë duke i eliminuar 8 kompani",*

Autoriteti kontraktues sqaron se kriter ka qenë Operatori Ekonomik i PËRGJEGJSHËM me çmimin më të ulët e jo vetëm çmimi më i ulët;

5. Për pretendimin tuaj se:

*"Pra Nese deshiron të bëjë keso dikriminime dhe favorizime me mire le të ju jep Tendere pa bërë publike por i therret direkt e të jujep atyre punen e jo të na qete në gare e në fund të na eliminoj për arsye banale",*

Autoriteti kontraktues sqaron se arsyet janë dhënë tek Letra Standarde për eliminim;

6. Për pretendimin tuaj se:

**" OE SELMAN NETWORK SH.P.K është një kompani që merret kryesisht me mirëmbajtje dhe pastrim të brendshëm të objekteve , prodhim etj dhe po i njëjti nuk e ka Veprimtarin e Ndërtimit mund të shihni me poshtë",**

Autoriteti kontraktues sqaron se kërkesë e FDT ka qenë "Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit" dhe si dëshmi "Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje)" dhe se nuk është kërkuar veprimtaria andaj kjo pikë e ankesës është e pabazuar. Më poshtë gjeni kriteret e DT për këtë pikë :

**Përshtatshmëria profesionale:**

**Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.**

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

**Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).**

7.Pretendimi juaj se është dorëzuar referenc pa kontratë - nuk qëndron sepse nuk është kërkuar kontratë por vetëm referenc ose certifikatë për kryerjen e punëve. Pra, është kërkuar "së paku një" e jo me shume referenca apo certifikata për kryerje të punëve- furnizim dhe vendosje të kabinave të ngjashme.


Më poshtë gjeni Vendimin e OSHP-së për këtë pikë, kriteret e DT dhe referencen:

Ne vazhdim ekspertit shqyrtues, sqaron se DT: ankues ka pretendime se i rekomanduarit për kontratë nuk e plotëson kërkesën për kontratë dhe referenca, me arsyetimin se i njëjti nuk ka dorëzuar fare kontratë për referencën e dorëzuar në ofertën e tij. Eksperti shqyrtues sqaron se nuk ka qenë kërkesë e DT-se, që të dorëzohen kontratat por vetëm lista e kontratave dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve - furnizim dhe vendosje të kabinave të ngjashme.


Ne rastin konkret OE i rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar referencën me titull: Ndërtimi i 16 nënstationeve të autobusëve në Komunën e Subarkës dhe e njëjta referenc gjendet edhe në listën e kontratave, pasi që në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të dëshmojë se ka përfunduar se paku një kontratë. Andaj, ky pretendim i OE ankues nuk qëndron.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional:</b> <b>Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë të natyrës së ngjashme për furnizim dhe</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> <b>Lista e kontratave të realizuara së paku një në 3 (tri) vitet e fundit, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e</b>
---	-----------	---	--

	vendosje të kabinave të ngjashme.	kontratës, datën e përfundimit dhe përfundimin, si dhe listën ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve-furnizim dhe vendosje të kabinave të ngjashme.
--	-----------------------------------	---



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINA SUHAREKË  
MUNICIPALITY OF SUHAREKË

**Për:** A&T & SELMANS NETWORK SH.PK  
**Nga:** Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë  
z.Beral Kabashi - Menaxher i projektit

**Subjekti:** REFERENCË për punimet e përfunduarra në vitin 2019

**Titulli i kontratës:** Ndërtimi i 16 nënstationeve të autobusëve në Komunën e Suharekës  
**Me numër identifikues:** 624-19-7865-S-2-1

Me kërkesë të DE A&T & SELMANS NETWORK SH.PK Prishtinë, dt.06.01.2020, Kuvendi Komunal, Suharekë, lëshoi këtë:

**REFERENCË**

Si dëshmi për punët e kryera nga DE A&T & SELMANS NETWORK SH.PK Prishtinë, për kuvendin Komunal Suharekë në projektin "Ndërtimi i 16 nënstationeve të autobusëve në Komunën e Suharekës" DE A&T & "Selmans Network" sh.p.k Prishtinë, ka qënë e përzgjedhur dhe kontraktuar nga ana e Kuvendit Komunal Suharekë, për kryerjen e punimeve ndërtim i nënstationeve në Komunën e Suharekës.


DE A&T & "Selmans Network" sh.p.k Prishtinë ka kryer të gjitha punët në ndërtimin i nënstationeve në mënyrë profesionale dhe brenda afatëve të parapara kohorë sipas vitit kalendrar 2019, në nivel dhe përgjegjësi të lartë.

Në af drejton e Shërbimit Publik në Menaxhim të kontratës, duke u bazuar në eksperiencën saj me kompaninë A&T & "Selmans Network" sh.p.k Prishtinë në përfaqësuar nga z Agim Troci drejtor, rekomandori kompaninë në fjalë si ndërmarrje serioze dhe profesionale për kryerjen e punëve ndërtim i 16 nënstationeve të autobusëve në Komunën e Suharekës.

Për çfarëdo informata shtesë, ju lutemi të mos hezitoni të na kontaktoni.

Me respekt,  
**Beral KABASHI**  
Menaxher i projektit

Date, 30/01/2020



Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i Vendimit në platformën elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>**

**Kopje:** Grupi i OEt Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës

Faton Gutaj  
  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

